

Progresi dhe sfidat e Komisionit të Pavarur për Media

RAPORT I MONITORIMIT 2024



Autorë: Gzim Shala dhe Florian Smalji

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Adresa: Rr. Ilaz Agushi, nr. 146
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org
Mars, 2025

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike osetë shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Publikimi i këtij raporti është bërë me mbështetje të Misionit të OSBE në Kosovë. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e OSBE.

LISTA E SHKURTESAVE

OSBE

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

KPM

Komisioni i Pavarur për Media

BA

Bordi i Ankesave

IKD

Instituti i Kosovës për Drejtësi

KUVENDI

Kuvendi i Kosovës

OShM

Ofrues i Shërbimeve Mediale

OSh

Ofrues i Shërbimeve

ARBK

Agjencia për Regjistrimin e
Bizneseve të Kosovës

ZKA

Zyra Kombëtare e Auditimit

RTK

Radio Televizioni i Kosovës

KMSHK

Këshilli i Mediave të Shkruara
të Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Metodologjia	7
3.	Analiza dhe gjetjet	8
3.1.	Përbërja e KPM-së	8
3.2.	Efikasiteti i punës së KPM-së	9
3.3.	Transparenca dhe llogaridhënia	9
3.4.	Përmbledhje e shkurtër e gjetjeve nga Zyra e Auditimit	10
3.5.	Mosfunksionimi dhe shpërbërja e Bordit të Ankesave (BA).....	12
3.6.	Legjislacioni sekondar dhe pjesëmarrja publike në vendimmarrje.....	13
3.7.	Monitorimi dhe sanksionimi	14
3.7.1.	Planet dhe burimet e KPM për të monitoruar mediat online gjatë fushatës zgjedhore sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme	16
3.8.	Trajtimi i ankesave.....	17
3.9.	Mbledhja e borxheve.....	17
3.9.1.	Sfidat për mbledhjen e borxhit të RTK.....	18
3.10.	Transparenca në pronësinë dhe koncentrimin medial.....	19
3.11.	Shpërndarja e fondeve për reklama.....	21
3.12.	Digjitalizimi	21
3.13.	Resurset e KPM-së.....	22
3.14.	Sulmi ndaj pavarësisë së KPM-së.....	23
3.14.1.	Presioni nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.....	23
3.14.2.	Ligji i ri për KPM	24
4.	Konkluzionet.....	26
5.	Rekomandimet	28
5.1.	Rekomandimet për KPM	28
5.2.	Rekomandimet për Kuvendin	28
5.3.	Rekomandime të përgjithshme	28
6.	Annexes	29
6.2.	Annex 1. Mbledhja e të dhënave dhe dokumentet kryesore të konsultuara.....	29
6.2.	Annex 2. Lista e të intervistuarve:	29

1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me mbështetje nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka monitoruar Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) nga qershori deri në shtator 2024, duke monitoruar mbledhjet e tyre dhe duke analizuar vendimet që lidhen me licencimin, zbatimin e rregullave, sanksionet dhe zhvillimet institucionale. Mirëpo, për shkak të zhvillimeve të ndryshme, raporti përfshinë periudha të ndryshme të vitit 2024. Përderisa, përpilimi i raportit është bërë gjatë muajit shtator, disa përditësime janë bërë para publikimit. Përmes mbledhjes së të dhënave, analizës ligjore dhe intervistave me akterë relevant, ky raport trajton transparencën, pavarësinë dhe sfidat e KPM-së, duke theksuar si progresin ashtu edhe fushat që kërkojnë përmirësime në rregullimin e mediave në Kosovë.

KPM ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar transparencën, duke përfshirë lansimin e një harte digjitale të pronësisë dhe përmirësimin e qasjes në të dhënat e pronësisë së mediave. Megjithatë, qasja në vendimet e publikuara në uebfaqen e saj zyrtare është e vështirë. Nga janari e deri në gusht të vitit 2024, KPM ka mbajtur tetë mbledhje dhe ka shqiptuar sanksione në vlerë prej 149,000 eurosh. Megjithatë, jo të gjitha vendimet janë publikuar.

Që nga rifunksionalizimi i KPM, me zgjedhjen e një anëtari të ri në maj të vitit 2023, ky institucion ka miratuar shtatë rregullore, të cilat dolën edhe në konsultime publike para miratimit. Me mbështetje nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, IKD hartoi Rregulloren për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM, e cila është miratuar nga KPM. Po ashtu, janë shfaqur përgjegjësi të reja për KPM-në pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, përfshirë zhvillimin e udhëzimeve që rregullojnë blerjen e kohës së transmetimit nga subjektet politike. Si përgjigje ndaj kësaj, IKD hartoi “Rregulloren për detyrimet e ofruesve të shërbimeve mediatike gjatë fushatës zgjedhore” pro bono, e cila është miratuar nga KPM.

Pavarësisht këtyre avancimeve, KPM vazhdon të përballet me disa sfida. Numri i të licencuarve është gjashtëfishuar që nga koha kur është krijuar, ndërsa numri i stafit ka mbetur i pandryshuar. Ky disbalans thekson nevojën për kapacitete shtesë njerëzore dhe, veçanërisht, teknologjike, sidomos në fushën e inteligjencës artificiale. Grumbullimi i borxheve mbetet një sfida e vazhdueshme, pavarësisht disa përpjekjeve, me borxhet e papaguara që aktualisht arrijnë në shumën 672,245.83 EUR¹.

Për më tepër, anëtarët e KPM-së janë përballur me presion politik nga deputetët e partisë në pushtet. Ligji i ri nr. 08/L-289 për KPM-në, i cili aktualisht është nën shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, përmban dispozita që mund të dëmtojnë pavarësinë e KPM-së.

Rekomandime kryesore:

- **Sigurimi i transparencës:** KPM duhet të publikojë të gjitha vendimet e saj në faqen zyrtare në gjuhët zyrtare;
- **Alokimi i burimeve të mjaftueshme:** Kuvendi duhet të adresojë kërkesat buxhetore të KPM-së, duke siguruar që kompetencat e zgjeruara të mbështeten me burime të mjaftueshme buxhetore për të përmbushur detyrimet e saj ligjore;

¹ Shënim: Kjo vlerë ka qenë në kohën kur ka filluar hartimi i raportit – shtator 2024.

- **Mbrojtja e pavarësisë institucionale:** Kuvendi duhet të sigurojë pavarësinë kushtetuese të KPM-së përmes ligjeve dhe veprimeve të tij;
- **Fuqizimi i përpjekjeve për grumbullimin e borxheve:** Edhe pse është bërë progres në këtë drejtim, KPM duhet të vazhdojë përpjekjet për të rikuperuar borxhet e papaguara.

2. Metodologjia

Për të zhvilluar një raport të gjithanshëm dhe analitik mbi kompetencat dhe funksionet e KPM-së, IKD ka adoptuar një qasje hulumtuese me metoda të përziera. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të detajuar të mënyrës sesi KPM i realizon përgjegjësitë e saj ligjore dhe rregullatore, duke u mbështetur në një gamë të gjerë burimesh të dhënash dhe metodologjish hulumtuese për të siguruar një analizë holistike. Një pjesë e rëndësishme e gjetjeve të paraqitura në këtë raport janë të nxjerra nga monitorimi i vazhdueshëm nga afër i aktiviteteve të KPM-së, nga IKD. Sa i përket këtij viti, IKD ka monitoruar në vazhdimësi mbledhjet e rregullta të KPM-së që nga janari, ka përgatitur raporte mbi zhvillimet në këto mbledhje, të cilat edhe janë publikuar rregullisht në portalin “Betimi për Drejtësi”. Ky monitorim i ka ofruar IKD-së informacione të drejtpërdrejta mbi proceset e vendimmarrjes të KPM-së, sfidat operative dhe përgjigjet ndaj çështjeve kryesore rregullatore.

Për të siguruar pasqyrim sa më të saktë në këtë raport, IKD nuk është mbështetur vetëm në të dhënat nga mbledhjet. Përveç kësaj, ka përdorur një gamë të larmishme burimesh të tjera për të paraqitur një pasqyrim më të plotë të punës së KPM-së. Konkretisht, IKD ka monitoruar uebfaqen zyrtare të KPM-së dhe faqen e tyre në platformat e mediave sociale, specifikuisht në Facebook. Duke ndjekur përdorimin e këtyre kanaleve digjitale nga KPM, IKD ka vlerësuar se sa efektivisht Komisioni komunikon me publikun, duke siguruar transparencë për aktivitetet dhe zhvillimet kryesore. Kjo analizë ka mundur një kuptim më të mirë të strategjive të KPM-së për përfshirjen e publikut dhe mënyrës se si ato janë në përputhje me detyrimet ligjore për të informuar dhe edukuar publikun.

Për më tepër, IKD ka raportuar vazhdimisht mbi ngjarjet e rëndësishme që lidhen me mandatin e KPM-së, duke kontribuar më tej në thellësinë e hulumtimit. Në portalin “Betimi për Drejtësi” janë publikuar lajme që mbulonin zhvillimet e rëndësishme të KPM-së, duke siguruar që publiku të qëndronte i informuar dhe i përfshirë me punën e Komisionit. Ky angazhim në kohë reale me ngjarjet në vazhdimësi, e ka përmirësuar më tej saktësinë dhe relevancën e raportit.

Përveç monitorimit, IKD ka dërguar kërkesa për informata në Zyrën e Komunikimit Publik të KPM-së. Këto kërkesa ishin drejtuar për të marrë informata lidhur të dhëna specifike mbi progresin e KPM-së në përmbushjen e detyrave të saj rregullatore dhe përditësimet mbi proceset e rëndësishme që janë në zhvillim. Informacioni i marrë në përgjigje të këtyre kërkesave ka ofruar njohuri të vlefshme të cilat janë integruar në raport, duke kontribuar në një kuptim më të qartë të trajtimit të përgjegjësive rregullatore nga ana e KPM-së. Këto gjetje ishin thelbësore për vlerësimin e mënyrës se si KPM i adreson sfidat që lidhen me rregullimin e mediave, transparencën e pronësisë dhe mbikëqyrjen e përmbajtjes.

Duke njohur rëndësinë e përfshirjes së perspektivave të ndryshme, IKD ka realizuar një seri intervistash me akterë relevantë kyç, si brenda ashtu edhe jashtë KPM-së.

Duke mbledhur njohuri nga një gamë e gjerë akterësh, IKD ka arritur të bëjë një paraqitje më të plotë të rolit të KPM-së, si dhe sfidave me të cilat ajo përballet në rregullimin e një sektori dinamik dhe shpeshherë të kontestuar. Përfshirja e pikëpamjeve të jashtme gjithashtu ndihmon në kontekstualizimin e punës së KPM-së brenda mjedisit më të gjerë politik dhe shoqëror, duke ofruar një kuptim më të hollësishëm të efektivitetit dhe kufizimeve të saj.

Një forcë kyçe e këtij raporti qëndron në përdorimin e një qasjeje hulumtuese me metoda të përziera, duke kombinuar teknika si kualitative ashtu edhe kuantitative. Aspekti kuantitativ përfshinte mbledhjen dhe analizën e të dhënave të lidhura me komunikimet publike të KPM-së, numrin e veprimeve rregullatore të ndërmarra, dhe trendet statistikore në pronësinë e mediave dhe shkeljet e përmbajtjes.

Në anën kualitative, analiza e IKD-së përqendrohet në kuptimin e pasojave më të thella të veprimeve të KPM-së, përmes analizimit të dokumenteve, intervistave dhe studimeve të rasteve. Kjo përfshinte shqyrtimin e narrativave që rrethojnë vendimet rregullatore të KPM-së, si dhe perceptimet e palëve të interesuara mbi efektivitetin e saj.

3. Analiza dhe gjetjet

3.1. Përbërja e KPM-së

Që nga tetori i vitit 2022, KPM ka pasur mungesë të kuorumit, kurse, funksionaliteti u rikthye më 24 maj 2023, kur Luljeta Aliu u zgjodh si anëtare, duke i mundësuar Komisionit zgjedhjen e kryetarit.² Mungesa e funksionimit të KPM-së për rreth shtatë muaj ndikoi në grumbullimin e shumë rasteve që kishin mbetur të pazgjidhura. Përveç kësaj, nga brenda KPM thuhet se grumbullimi i rasteve është rritur edhe për shkak të disa çështjeve që janë krijuar dhe kanë mbetur të pazgjidhura për rreth 10 vjet.³

Megjithatë, pavarësisht se u arrit të bëhej kuorumi, KPM ende nuk operon me kapacitet të plotë. Sipas ligjit,⁴ KPM duhet të ketë shtatë anëtarë, ndërkohë që në kohën e raportimit, janë të zgjedhur vetëm pesë anëtarë.

Në vitin 2024, u shpallën dy thirrje për aplikime për anëtarë të KPM-së. Megjithatë, të dyja thirrjet dështuan, dhe përbërja e plotë e Komisionit nuk u arrit.⁵

Fakti që KPM ka kuorum për të mbajtur mbledhje dhe për të marrë vendime nuk duhet të shërbejë si një justifikim për të lënë pozitat e mbetura të paplotësuara. Një Komision me përbërjen e tij të plotë do të ishte më i duhur.⁶ Edhe pse vendimet e KPM-së janë ligjërish të vlefshme, ato do të kishin më shumë legjitimitet nëse do të merren nga një përbërje e plotë e KPM-së, e përbërë nga shtatë anëtarë.

² “Luljeta Aliu-Krasniqi zgjidhet anëtare e Bordit të KPM-së”, Betimi për Drejtësi, 24 maj 2023, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/luljeta-aliu-krasniqi-zgjidhet-anetare-e-bordit-te-kpm-se/>), (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2023)

³ Intervistë me Besnik Berisha, Anëtar i KPM-së.

⁴ Ligji Nr. 04/l-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 10, paragrafi 1.

⁵ “Dështon intervistimi për përzgjedhjen e dy anëtarëve të KPM-së, rekomandohet rishpallja e konkursit pasi një kandidate u tërhoq nga gara”, Betimi për Drejtësi, 4 mars 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/njekandidate-terhiqet-nga-gara-deshton-konkursi-per-perzgjedhjen-e-dy-anetareve-te-kpm-se/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).; “Komisioni Ad-hoc: S’ka mjaftueshëm kandidatë, KPM të rishpallë konkursin për dy anëtarë”, Betimi për Drejtësi, 12 qershor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/komisioni-ad-hoc-ska-mjaftueshemkandidate-kpm-te-rishpalle-konkursin-per-dy-anetare/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

⁶ Intervistë me Christian Bötcher – kreu për Kulturë, Shtyp dhe Komunikime në Ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë.

Në kohën e publikimit të këtij raporti, mandati i Kryetarit të KPM-së, z. Jeton Mehmeti, ka përfunduar.

3.2. Efikasiteti i punës së KPM-së

Që nga fillimi i vitit deri në fund të gushtit 2024, KPM ka mbajtur tetë mbledhje të rregullta, duke përbushur kështu detyrimin ligjor që rrjedh nga Ligji për KPM-në, i cili parasheh që kryetari i KPM-së duhet të thërrasë një mbledhje të paktën një herë në muaj.⁷ Gjatë këtyre mbledhjeve, KPM ka shqyrtuar raste të ndryshme, përfshirë rekomandimet nga Zyra Ekzekutive lidhur me shkeljet nga të licencuarit, raste licencimi të subjekteve të ndryshme, ripërtëritje të licencave, kërkesa për ndryshime pronësie, etj.

IKD ka monitoruar nga afër mbledhjet e KPM-së dhe uebfaqen e saj zyrtare. Gjatë këtyre tetë mbledhjeve, KPM ka shqyrtuar gjithsej 49 raste të lidhura me çështje licencimi të subjekteve dhe 53 raste që përfshinin pretendime për shkelje nga të licencuarit.

Gjatë periudhës nga 1 maji deri më 15 gusht 2024, në tre mbledhjet e mbajtura, KPM ka marrë 18 vendime, 12 prej të cilëve kanë të bëjnë me pretendime për shkelje nga të licencuarit dhe gjashtë lidhur me çështje licencimi. Në 17 nga këto vendime, KPM miratoi rekomandimin e Zyrës Ekzekutive, ndërsa në një rast e refuzoi atë.

Për më tepër, KPM kishte formuar katër nënkomisione, të cilat u krijuan për të analizuar katër çështje, si: 1) çështja e frekuencave dhe sidomos ato në rajon, 2) borxhet e akumuluar ndaj KPM-së, 3) ndryshimi i pronësisë, dhe 4) detyrimet që dalin nga Ligji për të Drejtat e Autorit. Raportet për secilin nga këto nënkomisione janë përgatitur dhe miratuar nga KPM.⁸

Siç u përmend në kapitullin paraprak, KPM u desh që të adresojë një grumbull punësh, qw ishin krijuar nga më herët. Sipas disa të intervistuarve, KPM ka qenë mjaft efikase në përbushjen e të gjitha detyrave që kishin mbetur nga ajo kohë, si dhe atyre që kanë lindur me kalimin e kohës.⁹ Ndërkohë, lidhur me objektivat e punës, u tha se deri në mes të gushtit 2024, 60% e tyre tashmë ishin përbushur.¹⁰ Akterët e jashtëm gjithashtu theksuan vlerësimin e tyre për punën e përbërjes aktuale të KPM-së,¹¹ ndërsa u theksua si shqetësim që KPM ka vepruar me një U.D Drejtor Ekzekutiv që nga 2 korriku 2021.¹²

3.3. Transparenca dhe llogaridhënia

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, IKD ka monitoruar vazhdimisht si uebfaqen zyrtare të KPM-së, ashtu edhe faqen e saj zyrtare në rrjetin social 'Facebook'. Si rezultat i këtij monitorimi, IKD ka gjetur se KPM, përmes këtyre dy kanaleve, informon publikun paraprakisht për caktimin e mbledhjeve të rregullta dhe agjendën për ato mbledhje. Po ashtu, KPM, përmes njoftimeve për media, çdoherë ka informuar publikun mbi vendimet dhe ngjarjet

⁷ Ligji Nr. 04/l-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 15, paragrafi 3.

⁸ Përgjigje e shkruar nga Zyra për Komunikim me Publikun e KPM-së, 09.09.2024.

⁹ Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së, Fitim Veliu - anëtar në KPM.

¹⁰ Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

¹¹ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Flaka Surroi – “Koha”; Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media.

¹² Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

e tjera të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë këtyre mbledhjeve. Gjithashtu, të gjitha këto mbledhje kanë qenë të hapura për publikun, siç parashihet nga Ligji për KPM-në.¹³

Ndërkohë, një çështje më problematike është publikimi i vendimeve, të cilat ende nuk janë publikuar (mbledhjet e mbajtura nga maji deri në gusht).¹⁴ Megjithatë, shumica e vendimeve nga mbledhjet e mëparshme të këtij viti janë publikuar.

Një aspekt tjetër problematik është mënyra se si vendimet, që tashmë janë publikuar, bëhen të qasshme, pasi qasja në to është teknikisht e vështirë. Ato nuk publikohen në një link të veçantë ose në një mënyrë tjetër të kategorizuar, por publikohen vetëm si “hyperlink” brenda njoftimeve të mbledhjeve. Ky problem vjen nga dizajni i papërshtatshëm i uebfaqes zyrtare të KPM-së.

Isak Shabani, anëtar i Komisionit Parlamentar për Media, nga partia opozitare (Partia Demokratike e Kosovës, PDK), thotë se web-faqja zyrtare duhet të dizajnohet në një mënyrë që mundëson transparencë edhe më efektive, me një strukturë adekuate dhe kategorizim të duhur të informacionit arkivor, dhe duhet të përfshijë një modul më efikas ku palët mund të paraqesin ankesa.¹⁵ Megjithatë, përmes intervistave, u mësua nga KPM se kompania për krijimin e web-faqes të re është tashmë rekrutuar, dhe pritet që të bëhet funksionale deri në fund të vitit 2024.¹⁶

Kështu, KPM ka bërë përmirësime në lidhje me transparencën¹⁷ dhe shumica e të intervistuarve të tjerë thonë se transparenca nuk mungon në KPM.¹⁸ Në fakt, është përmendur se KPM është një nga institucionet më transparente¹⁹, duke theksuar faktin se mbledhjet e KPM-së janë gjithmonë të hapura dhe monitorohen vazhdimisht nga shoqëria civile, në këtë rast nga IKD, si dhe rëndësinë që i jepet përgjigjes ndaj kërkesave për informacion drejtuar KPM-së.²⁰ Për më tepër, lansimi i hartës digjitale, e cila ofron qasje në të dhëna mbi të licencuarit e KPM-së dhe pronësinë e tyre, është përmendur gjithashtu si një zhvillim pozitiv në këtë drejtim.²¹

3.4. Përmbledhje e shkurtër e gjetjeve nga Zyra e Auditimit

Në qershor 2024, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) publikoi Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Media për Vitin 2023.²² Raporti thekson si gjetje se ZKA ka identifikuar fusha ku mund të përmirësohet performanca, përfshirë

¹³ Po aty, Neni 7, paragrafi 4.

¹⁴ Lajmet e KPM-së për takimet e mbajtura gjatë periudhës maj-gusht, pa vendime të publikuara, (shih linqet: https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3711; https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3699; https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3688; https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3711), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

¹⁵ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

¹⁶ Intervistë me Jeton Mehmeti – Kryetar i KPM-së; Intervistë me Besnik Berisha – Anëtar i KPM.

¹⁷ Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i KMSHk; Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Cështje Ligiore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

¹⁸ Intervistë me Flaka Surroi – “Koha”; Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media; Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së; Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM; Intervistë me Besnik Berisha - Anëtar i KPM.

¹⁹ Intervistë me Besnik Berisha – Anëtar i KPM.

²⁰ Intervistë me Besnik Berisha – Anëtar i KPM; Intervistë me Jeton Mehmeti – Kryetar i KPM; Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

²¹ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Jeton Mehmeti – Kryetar i KPM; Intervistë me Besnik Berisha – Anëtar i KPM.

²² Zyra e Auditimit te Përgjithshme, “Raporti i Auditimit per Pasqyrat Financiare Vjetore te Komisionit te Pavarur per Media per vitin 2023”, qershor 2024, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_f4d65c5b-08d4-4393-a0c9-5eae5edddccb.PDF). (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

kontrollet e brendshme. Raporti pohon se testet e kryera treguan nevojën për përmirësime në menaxhimin e burimeve njerëzore.²³

Kështu, nga ky raport ka rezultuar një rekomandim i ri, i cili do të ndiqet gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Theksohet se nuk pati gjetje për vitin 2022.

Sa i përket gjetjes së mësipërme të raportit të ZKA-së për vitin 2023, në dhjetor 2023 KPM miratoi Rregulloren Nr. 04_2023 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Drejtorit Ekzekutiv. Në vitin 2024, u shpall dy herë me radhë konkursi për Drejtor Ekzekutiv të KPM-së. Herën e parë, konkursi dështoi sepse nuk kishte aplikantë/kandidatë që plotësonin kriteret e kualifikimit të konkursit. Në shpalljen e dytë, procesi u ndal në gjysmë, pasi disa anëtarë të Komisionit të Vlerësimit dhanë dorëheqjen, duke çuar në një situatë ku procedura nuk mund të vazhdonte, dhe kështu konkursi u anulua, por pritet që të shpallet përsëri së shpejti.

Ndërkohë, në mars 2024, ZKA publikoi një Raport Auditimi të Performancës për menaxhimin e licencave në KPM.²⁴ Sipas këtij raporti, gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që lidhen me menaxhimin e licencave nga KPM kërkojnë përmirësim të menjëhershëm. Në këtë drejtim, ZKA ka ofruar pesë rekomandime.²⁵

Rekomandimet nga ky auditim theksojnë se KPM duhet të rrisë nivelin e menaxhimit të licencave të OSh-ve dhe të zbatojë një proces më të mirë për menaxhimin e medias.²⁶ Sipas raportit, këto mund të bëhen përmes:

- Fuqizimit të sistemit të licencimit dhe monitorimit i cili është thelbësor për të siguruar që operatorët e shpërndarjes t'i përmbahen të gjitha kriterëve të licencimit dhe realizimit të shërbimeve;
- Zbatimit të afateve të qarta kohore dhe masave konkrete për vonesat apo devijimet nga kriteret në mënyrë që të parandalohen rreziqet që lidhen me ripërtëritjen e licencave;
- Dhënies së rekomandimeve të qarta gjatë procesit të ripërtëritjes së licencave në mënyrë që të sigurojnë standardizim dhe konsistencë;
- Shfrytëzimit efikas të mekanizmave siç janë, pezullimi, ndërprerja/revokimi i licencave ndaj OSH-ve të cilat nuk zhvillojnë aktivitete transmetuese, nuk kryejnë obligimet financiare dhe bëjnë shkelje të kriterëve mediatike;
- Rritjes së monitorimit të OSH-ve për aktivitetet e tyre transmetuese duke koordinuar veprimet në mes të departamenteve në KPM për një mbikëqyrje efektive të licencave dhe pagesave.

Lidhur me adresimin e kësaj gjetje, KPM ka vepruar konform rekomandimeve të ZKA-së, konkretisht të gjitha pagesat që nuk janë paguar sipas afatit ligjor, janë përcjell në procedurë përmbarimore. Të gjitha subjektet e licencuara që kanë borxhe paraprake nuk mund të kryejnë shërbime administrative të ndryshme sipas kërkesave të tyre, pa i kryer obligimet financiare dhe të tjera ndaj KPM-së, asnjë ripërtëritje licence. Janë përdoruar mekanizma siç janë

²³ Po aty, Neni 2, Faqe 7, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_f4d65c5b-08d4-4393-a0c9-5eae5edddccb.PDF). (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

²⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, "Raporti i Auditimit të Performancës", mars 2024, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_c6180d99-2ce9-493e-9f43-303b7e5d1d03.pdf). (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

²⁵ Po aty, Faqe 2, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_f4d65c5b-08d4-4393-a0c9-5eae5edddccb.PDF). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

²⁶ Po aty, Neni 5, Faqe 29, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_c6180d99-2ce9-493e-9f43-303b7e5d1d03.pdf). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

përmendur në rekomandime sa i përket mos transmetimit, pra ndërprerja/revokimi i licencave ndaj të licencuarve të cilat nuk zhvillojnë aktivitete transmetuese. Gjithsesi adresimi i këtyre rekomandimeve është në proces e sipër dhe deri në fund të vitit planifikon ta finalizojë zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së.²⁷

Për më tepër, raporti i auditimit ofron shpjegime lidhur me borxhet e papaguara që u detyrohen KPM-së, të cilat do të shtjellohen më tej në një kapitull tjetër të këtij raporti.

3.5. Mosfunksionimi dhe shpërbërja e Bordit të Ankesave (BA)

Brenda KPM-së, ekziston gjithashtu një Bord i Ankesave (BA), i cili shqyrton ankesat kundër vendimeve të KPM-së.²⁸ Ky bord përbëhet nga tre anëtarë.²⁹ Megjithëse është shumë i rëndësishëm, për shkak të mungesës së kuoromit, ky Bord ka qenë jo-funksional që nga 29 tetori 2023. Deri në fund të gushtit 2024, BA kishte vetëm një anëtar dhe i mungonte kuorumi për të marrë vendime.³⁰ Kjo situatë ka lindur për shkak të dështimit për të kompletuar përbërjen e këtij Bordi me anëtarët e tjerë. Gjatë zhvillimit të intervistave, u përmend gjithashtu se janë bërë disa herë thirrje për aplikime për anëtarësim në këtë Bord, por ka pasur shumë pak aplikantë, akoma më pak ata që plotësojnë kriteret, dhe në disa raste, aplikantët nuk janë paraqitur për intervistë, duke çuar në dështimin e konkursit.³¹

Sa i përket mosfunksionimit të këtij Bordi dhe ndikimit ose pasojave që kjo sjell, kishte mendime të ndryshme nga të intervistuarit. Disa e shihnin këtë si problematike³², duke theksuar se, përveç ndikimit të tij në punën e KPM-së³³, kjo gjithashtu ka një ndikim negativ te media³⁴, dhe palët e tjera të përfshira.³⁵ U përmend gjithashtu se secili vendim i marrë nga KPM do duhej të ishte i kontestueshëm para këtij trupi, ashtu që shpeshherë të mund të shmangej kontesti administrativ në gjykatë.³⁶

Sipas Ligjit të ri për KPM-në, BA do të shpërbëhet. Kështu, sipas ligjit të ri, brenda kuadrit të procedurave administrative, vendimet e KPM-së do të jenë përfundimtare dhe nuk do të ekzistojë asnjë mekanizëm brenda procedurës administrative për të shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të KPM-së. Këto vendime mund të kontestohen vetëm në gjykatë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative.

Në lidhje me ankesat, ligji i ri ka përcaktuar krijimin e Këshillit të Ankesave. Në këtë kontekst, për këtë Këshill, ligji i ri thotë se ai do të trajtojë ankesat nga palët në lidhje me subjektet në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore. Nga leximi i këtij neni, në lidhje me funksionimin e përgjithshëm të KPM-së, mund të arrijmë në përfundimin se ky Këshill ka një natyrë të ndryshme krahasuar me BA-në. Kjo për shkak se Këshilli i Ankesave është brenda Zyrës Ekzekutive, që do të trajtojë ankesat e paraqitura nga palët. Pas këtij shqyrtimi, vendimi përfundimtar do të merret nga KPM. Kundër këtij vendimi nuk do të ekzistojë një shkallë e

²⁷ Përgjigje e shkruar nga Zyra për Komunikim me Publikun e KPM-së.

²⁸ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/ORGANOGRAMI%20%202019.pdf>

²⁹ Ligji për KPM.

³⁰ <https://www.kpm-ks.org/kpm/329/perberja-e-bordit-per-ankesa/329>; Përgjigje e shkruar nga Zyra për Komunikim me Publikun e KPM-së, 09/09/2024

³¹ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK.

³² Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i KMSHK.

³³ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

³⁴ Intervistë me Flaka Surroi – “Koha”.

³⁵ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

³⁶ Intervistë me Flaka Surroi – “Koha”.

dytë, siç ka qenë rasti më parë me BA-në. Vendimet e KPM-së mund të kontestohen vetëm në gjykatë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative.

Sipas këtij ligji, vendimet e KPM-së do të jenë përfundimtare, dhe çdo ankim kundër tyre mund të bëhet vetëm në gjykatë.

Disa nga të intervistuarit u shprehën se shpërbërja e këtij Bordi është një gabim, kjo për shkak të natyrës së punës me median dhe vonesave që mund të lindin në procedurat gjyqësore. Për shembull, nëse KPM merr një vendim për mbylljen e një transmetuesi ose edhe raste të tjera, atëherë çështja mund të zvarritet, ndërkohë që me BA-në, qasja e mediave është shumë më e lehtë pasi vendimet merren më shpejt, duke mundësuar një media të pavarur dhe funksionale.³⁷ Në fakt, është përmendur madje se një veprim i tillë shkel Nenin 32 (E drejta për Mjete Ligjore) të Kushtetutës.³⁸ Nga ana tjetër, ka edhe mendim se ky Bord nuk duhej të kishte ekzistuar kurrë, pasi apelimet mund të bëhen tashmë në gjykatën përkatëse.

3.6. Legjislacioni sekondar dhe pjesëmarrja publike në vendimmarrje

Që nga fillimi i funksionimit të KPM-së në maj të vitit 2023, KPM ka miratuar shtatë rregullore, të cilat gjithashtu janë nxjerrë për konsultim publik para miratimit të tyre. Me mbështetje të OSBE-së, IKD ka hartuar Rregulloren për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM, e cila është miratuar nga KPM. Po ashtu, detyrime të reja për KPM-në lindin edhe nga miratimi i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Njëra prej këtyre detyrimeve është miratimi i udhëzimeve për rregullimin e blerjes së kohës së transmetimit nga subjektet politike në mediat transmetuese. Në lidhje me këtë, IKD ka hartuar “Rregulloren për detyrimet e ofruesve të shërbimeve mediatike gjatë fushatës zgjedhore” pro bono, e cila është miratuar nga KPM.

Rregulloret e miratuara deri më 16 dhjetor 2024 janë:

- 1) Rregullorja për Pranimin, Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Kryeshefit Ekzekutiv³⁹;
- 2) Rregullorja për Pronësinë dhe Koncentrimin e Licencave të KPM-së⁴⁰;
- 3) Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale⁴¹;
- 4) Rregullorja për Komunikatat Komerciale Audio dhe Audiovizuale⁴², të cilat janë gjithashtu publikuar në faqen zyrtare të KPM-së.⁴³

³⁷ Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

³⁸ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

³⁹ Rregullorja për Pranimin, Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Kryeshefit Ekzekutiv (shih linkun: https://www.KPM-ks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20Nr.%2004_2023%20p%C3%ABr%20Pranimin%2C%20Vler%C3%ABsimin%2C%20dhe%20Disiplin%C3%ABn%20e%20Kryeshefit%20Ekzekutiv.pdf), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴⁰ Rregullorja për Pronësinë dhe Koncentrimin e Licencave të KPM-së; (shih linkun: <https://www.KPM-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20PRONESIN%20DHE%20KONC.E%20TE%20LIC%20TE%20KPM%20%202023.pdf>), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴¹ Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale, (shih linkun: [https://www.KPM-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20MBROJTJEN%20E%20FEMIJEVE%20DHE%20TE%20MITURVE%20NE%20SHMA\(1\).pdf](https://www.KPM-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20MBROJTJEN%20E%20FEMIJEVE%20DHE%20TE%20MITURVE%20NE%20SHMA(1).pdf)), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴² Rregullorja për Komunikatat Komerciale Audio dhe Audiovizuale, (shih linkun: [https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20MBROJTJEN%20E%20FEMIJEVE%20DHE%20TE%20MITURVE%20NE%20SHMA\(1\).pdf](https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/RREGULLORE%20PER%20MBROJTJEN%20E%20FEMIJEVE%20DHE%20TE%20MITURVE%20NE%20SHMA(1).pdf)), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴³ Uebfaqja e KPM-së (shih linkun: <https://www.KPM-ks.org/al/legjislacioni/299/aktet-nenligjore-ne-fuqi/299>), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

- 5) Rregullorja për Mbrojtjen e Përdoruesve në Fushën e Ofrimit të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale;
- 6) Rregullorja për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM dhe
- 7) Rregullorja për detyrimet e ofruesve të shërbimeve mediatike gjatë fushatës zgjedhore.

3.7. Monitorimi dhe sanksionimi

Monitorimi i shërbimeve mediale audiovizuale dhe inicimi dhe pranimi i ankesave lidhur me mosrespektimin e kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve të tjera ligjore në përputhje me ligjin aktual, është një nga kompetencat e KPM-së.⁴⁴

Aktualisht, KPM ka të licencuar 84 stacione radio, 19 kanale televizive tokësore, 34 operatorë shpërndarës dhe 119 kanale që transmetojnë përmes operatorëve.⁴⁵ Sistemi i përdorur për monitorim është XentauriX Broadcast Logger - Media dhe Broadcast Recorder.⁴⁶ Po ashtu, duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike, veçanërisht në fushën e inteligjencës artificiale, mbështetur nga projektet kapitale, KPM është në proces të përmirësimit të hardware dhe software-it të sistemit të tij të monitorimit për një monitorim më efektiv të të licencuarve, duke përfshirë AI, transkriptimin, njohjen e fytyrës etj.⁴⁷

Monitorimi ka qenë gjithashtu një nga mangësitë që është theksuar në raportin e ZKA.⁴⁸ Megjithatë, njëri nga anëtarët e KPM-së ka pohuar se qasja e monitorimit është rregulluar, tani duke u përqendruar aty ku janë vënë re probleme, dhe në ato raste ku është kërkuar monitorim.⁴⁹

Gjatë periudhës nga 1 maji deri më 15 gusht, si rezultat i monitorimit, janë iniciuar 79 raste kundër shërbimeve mediale audiovizuale.⁵⁰ Gjatë kësaj periudhe, janë vendosur sanksione gjatë mbledhjes së pestë të rregullt të KPM-së, të mbajtur më 10 maj 2024.⁵¹ Këto raste lidhen me shkelje të vazhdueshme të Rregullores për Operatorët e Shpërndarjes dhe Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e të Licencuarve. Në këto raste, janë vendosur gjopa në total në vlerën e tetë mijë euro për gjashtë të licencuar.

Për më tepër, janë vendosur sanksione gjatë mbledhjes së gjashtë të rregullt të KPM-së, të mbajtur më 10 qershor 2024.⁵² Të gjitha këto raste lidhen me ndryshimin e pronësisë pa miratimin paraprak nga KPM. Në këto raste, janë shqiptuar gjopa në vlerën e 10 (dhjetë mijë) euro për gjashtë të licencuar.

Një kompetencë tjetër e KPM-së është sanksionimi i të licencuarve për shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve të tjera ligjore në përputhje me këtë ligj.⁵³ Brenda kësaj kompetence, për shkelje të kushteve të licencës, ligjit ose akteve nënligjore të KPM-së, KPM

⁴⁴ Ligji për KPM, Neni 29, Paragrafi 1.

⁴⁵ Harta Digjitale (shih linkun: <https://regjistri.KPM-ks.org/>), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së; Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publikun e KPM-së.

⁴⁸ Zyra e Auditimit, "Raporti i Auditimit të Performances", mars 2024, Faqe 6, (shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_c6180d99-2ce9-493e-9f43-303b7e5d1d03.pdf), (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

⁴⁹ Intervistë me Besnik Berisha, Anëtar i KPM-së.

⁵⁰ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publikun e KPM-së, 09.09.2024

⁵¹ Mbledhja e pestë e rregullt e KPM-së, (Shih linkun: https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3688)

⁵² Mbledhja e gjashtë e rregullt e KPM-së, (Shih linkun: https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3699)

⁵³ Po aty, Neni 30, Paragrafi 1.

mund të lëshojë vërejtje me shkrim ose të vendosë gjoba në vlera prej 1,000 euro deri në 100,000 euro.⁵⁴

Gjatë intervistave, është thënë se KPM ka ndërmarrë hapa pozitivë në lidhje me çështjen e vendosjes së sanksioneve.⁵⁵

IKD gjen se gjatë këtij viti, KPM ka shqyrtuar gjithsej 34 raste lidhur me shkeljet e të licencuarve, të lidhura me shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve të tjera ligjore nga të licencuarit e KPM-së, në përputhje me Ligjin për KPM. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, KPM ka vendosur gjoba me një total prej 149,000 euro, ka lëshuar një paralajmërim dhe në tre raste, ka sanksionuar me pezullim të licencës. Gjoba më e lartë e vendosur ka qenë 64,000 euro, ndërsa gjoba më e ulët ka qenë shuma minimale që KPM mund të vendosë, që është 1,000 euro.

Gjobë më e lartë e vendosur nga KPM është vendosur në mbledhjen e parë të rregullt të saj të këtij viti, të mbajtur më 19 janar 2024. Një sanksion është vendosur ndaj Artmotion (64,000 euro). Në të njëjtin rast, është vendosur gjithashtu një gjobë ndaj Kujtesës (26,000 euro), IPKO-së (7,000 euro), dhe Telkos-it (3,000 euro)⁵⁶. Vendosja e gjobës ka qenë proporcionale me numrin e ankesave që KPM ka marrë ndaj operatorëve të lartpërmendur. Natyra e ankesave ishte e ngjashme, pasi abonuesit kishin pretenduar për reklamim mashtrues dhe për mosnjofitim të qytetarëve për ndryshimin e pakos, e që kanë të bëjnë me mostransmetimin e kanaleve të “Digitalb”, si dhe “Super Sport”, “Top Channel” dhe “Klan TV”. Që nga fillimi i vitit deri në atë mbledhje, janë regjistruar mbi 300 ankesa, më 221 ankesa ndaj Artmotion, 87 ndaj Kujtesës, 23 ndaj IPKO-së dhe 9 ndaj Telkos-it.

Në këtë rast specifik, KPM trajtoi të gjitha ankesat si një rast i vetëm, kështu që për mbi 300 ankesa ndaj të licencuarve, vendosi vetëm një sanksion. Për më tepër, KPM shpërndau gjobën maksimale të parashikuar nga ligji (100,000 euro) në mënyrë proporcionale, bazuar në numrin e ankesave që kishte marrë. Në këtë rast të veçantë, IKD vëren se KPM nuk ka aplikuar ligjin në mënyrë të saktë. Neni 30 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave liston masat që KPM mund të vendosë për secilin prej të licencuarve, ndërsa gjoba e vendosur nga KPM është e natyrës individuale. Për rrjedhojë, gjoba maksimale nuk duhej të ishte konsideruar 100,000 euro për të gjithë të licencuarit ndaj të cilëve janë marrë ankesat, por ky kufi duhej të konsiderohej veçmas për secilin prej tyre. Fakti që ankesat e marra kanë qenë për të njëjtin problem nuk nënkupton që duhet të vendoset vetëm një gjobë për të gjithë, por përkundrazi, përgjegjësia e secilit është individuale, dhe sanksioni për një të licencuar nuk është i lidhur me sanksionin ndaj tjetrit.

Në anën tjetër, ndonëse KPM ka shqyrtuar ankesa të shumta lidhur me shkelje nga të licencuarit, jo të gjitha detajet e procesit të trajtimit të ankesave nga KPM ishin të definuara qartë. Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe e të pasurit së një rregulloreje të tillë, me mbështetje të OSBE-së, IKD ka draftuar Rregulloren për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM.

⁵⁴ Po aty, Paragrafi 1.3.

⁵⁵ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

⁵⁶ “Artmotion dënohet me 64 mijë euro, Kujtesa më 26 mijë euro, IPKO me 7 mijë euro dhe Telkos me 3 mijë euro”, Betimi për Drejtësi, 19 janar 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/artmotion-denohet-me-64-mije-euro-kujtesa-me-26-mije-euro-ipko-me-7-mije-euro-dhe-telkos-me-3-mije-euro/>). (Qasur për here të fundit më 13 shtator 2024).

3.7.1. Planet dhe burimet e KPM për të monitoruar mediat online gjatë fushatës zgjedhore sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KPM ka obligim të miratojë udhëzime për rregullimin e blerjes së kohës së transmetimit nga subjektet politike në mediat e transmetimit.⁵⁷ Gjithashtu, janë përcaktuar disa kompetenca të tjera për KPM-në, përfshirë sigurimin dhe marrjen e regjistrave të veçantë ditorë që duhet të mbahen nga transmetuesit, si dhe zbatimin e afateve të shkurtra për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ankesat që lidhen me procesin zgjedhor.⁵⁸ Duke pasur parasysh se disa intervistues besojnë se KPM-së i mungojnë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe duke marrë parasysh se aktualisht mbikëqyrë një total prej 250 të licencuarve, mund të konkludohet se KPM do të ketë nevojë për një kapacitet më të lartë për të mbuluar të gjitha këto përgjegjësi shtesë gjatë periudhave të zgjedhjeve, veçanërisht nëse hyn në fuqi Ligji i ri për KPM-në.

Kjo për shkak se me miratimin e Ligjit të ri për KPM-në në Kuvend, kompetencat e KPM-së tani përfshijnë edhe mediat online.⁵⁹ Ky Ligj specifikon se KPM rregullon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik që ofrojnë shërbime mediale audio, audiovizuale përfshirë ato të ofruara online, shërbimet e platformës për shkëmbimin e videove, operatorët e shpërndarjes si dhe operatorët e tjerë të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë ofruet të shërbimeve mediale audiovizuale.

Megjithatë, kapacitetet aktuale mbeten të njëjta si ato gjatë zgjedhjeve të kaluara.⁶⁰ Prandaj, numri i vogël i stafit në krahasim me numrin e madh të mediave që duhet të monitorohen paraqet një sfidë për KPM-në lidhur me zgjedhjet e përgjithshme që po vijnë, veçanërisht nëse përfshihen mediat online.

Gjatë intervistave, u përmend gjithashtu rreziku që KPM-ja të bëhet jo-funksionale gjatë periudhës së zgjedhjeve, bazuar në faktin se mandatet e kryetarit dhe nënkryetarit do të skadojnë në janar të vitit 2025.⁶¹

Megjithatë, KPM-ja tani është duke përfunduar përgatitjet për monitorimin e mediave gjatë zgjedhjeve me kapacitetet e saj aktuale. Për më tepër, KPM-ja është duke hartuar Udhëzuesin e ri për mediat lidhur me zgjedhjet, në përputhje me detyrimet ligjore sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe po ndërmerret gjithashtu përgatitje teknike dhe të stafit për këtë proces.

Për të përfunduar legjislacionin e dytë të rëndësishëm lidhur me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, KPM ka kërkuar ndihmë profesionale nga IKD për hartimin e këtyre akteve. Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë, IKD ka shprehur gatishmërinë e saj për të hartuar këto akte pa pagesë dhe për të lehtësuar të gjitha aktivitetet e KPM-së deri në miratimin e këtyre akteve. Për më tepër, më 24 shtator, KPM-ja ka krijuar gjithashtu një grup

⁵⁷ Ligji Nr. 08/-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Neni 48, Paragrafi 2.

⁵⁸ Po aty, Neni 51, paragrafi 5.

⁵⁹ Draft Ligji Nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, Neni 4, (shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/289PLperKomisioninePavarurperMedia_hAuu8cVVuX.pdf). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁶⁰ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së, 09.09.2024.

⁶¹ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Cështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

pune për hartimin e legjislacionit të dytë lidhur me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.

3.8. Trajtimi i ankesave

Një prej përgjegjësive të KPM është poashtu edhe trajtimi i ankesave të parashtruara ndaj të licencuarve. Deri më tani, ushtrimi i kësaj kompetence ka qenë mjaftë problematike, kryesisht për shkak se KPM deri më tani nuk ka pasur ndonjë rregullore që ka përcaktuar në detaje procedurën e trajtimit të këtyre ankesave. Gjithashtu, në KPM është theksuar gjithnjë se numri i ankesave është në rritje vazhdimisht, gjë që e ka bërë edhe më sfiduese trajtimin e tyre. Për më tepër, vetëm në fillim të këtij viti, KPM ka pranuar rreth 400 ankesave, duke shënuar një rekord të ri të numrit të ankesave të pranuar.⁶² Sidoqoftë, ky numër rekord ka qenë për shkak të largimit dhe mos-transmetimit të kanaleve të “Digitalb”, “Super Sport”, “Top Chanel”, dhe “Klan TV” nga operatorët e shpërndarjes, duke rezultuar kështu në ankesa të natyrës së ngjashme, përmes së cilave qytetarët pretenduan për reklamim mashtrues dhe mos-njoftim të tyre për ndryshime të pakove.⁶³

Ndërkaq, nga muaji maj deri më 15 gusht të vitit 2024, në KPM janë pranuar tri ankesa kundër subjekteve të licencuara⁶⁴. Dy prej këtyre ankesave kanë pasur të bëjnë me transmetim të paautorizuar dhe një rast tjetër me shkelje të Kodit të Etikës.⁶⁵

Sipas disa të intervistuarve, përfshirë edhe atyre jashtë KPM-së, ankesat trajtohen në mënyrë të duhur⁶⁶, veçanërisht nëse krahasohet me të kaluarën.⁶⁷

Ndërkaq, lidhur me trajtimin e ankesave, kishte edhe mendim tjetër, duke theksuar se ka mundësi që të ketë standarde të dyfishta, duke thënë se mund të ndodhin manovrim brenda zyrës ekzekutive lidhur me trajtimin e ankesave dhe fuqisë ekonomike të medieve.⁶⁸

3.9. Mbledhja e borxheve⁶⁹

Mbledhja e borxheve të grumbulluara ndaj KPM-së, vazhdon të jetë një sfidë për këtë institucion, pavarësisht përpjekjeve për të adresuar këtë çështje. Vlen të theksohet se më 27 qershor 2023, gjatë prezantimit të raportit vjetor të vitit 2022, para Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, KPM theksoi se borxhi i akumuluar ndaj tyre është një prej sfidave të mëdha.⁷⁰

⁶² Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

⁶³ “*Artmotion denohet me 64 mijë euro, Kujtesa më 26 mijë euro, IPKO me 7 mijë euro dhe Telkos me 3 mijë euro*”, Betimi për Drejtësi, 19 janar 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/artmotion-denohe-me-64-mije-euro-kujtesa-me-26-mije-euro-ipko-me-7-mije-euro-dhe-telkos-me-3-mije-euro/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁶⁴ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së, 09.09.2024.

⁶⁵ Ibid.

⁶⁶ Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i KMSHK; Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media

⁶⁷ Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media.

⁶⁸ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK.

⁶⁹ *Shënim: Të dhënat në këtë kapitull i takojnë periudhës gjatë së cilës është draftuar raporti.*

⁷⁰ “*KPM prezanton raportin vjetor për 2022-ën: Borxhet e grumbulluara ndër vite ndaj KPM-së, sfida kryesore*”, Betimi për Drejtësi, 27 qershor 2023, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KPM-prezanton-raportin-vjetor-per-2022-en-borxhet-e-grumbulluara-nder-vite-ndaj-KPM-se-sfida-kryesore/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

Në këtë prezantim, u bë e ditur se në fund të vitit 2022, ndaj KPM ishte grumbulluar në total një borxh prej rreth 800,000,00 euro, prej të cilave, 500,000.00 euro kishin të bënin me taksat e licencave.

Ndërkaq, më 17 korrik 2023, gjatë një mbledhje të rregullt, KPM mori vendim përmes të cilit të gjithë të licencuarit që kishin borxhe të grumbulluara, detyroheshin që brenda 30 ditëve, të dorëzonin në KPM një marrëveshje, e cila duhej të dëshmonte që të licencuarit kanë programuar pagimin e borxheve brenda një periudhe prej 12 muaj.⁷¹

Në kohën kur është marrë ky vendim, borxhi i grumbulluar ishte 796,020.04 euro. Ndërsa, 12 muaj pas këtij vendimi, përjashtuar faturat e pranuar pas 19 korrikut 2023, borxhi i grumbulluar ishte 672,245.83 euro. Bazuar në këtë, i bie që rreth 84.45% e borxhit kishte mbetur pa u paguar. Të gjitha rastet kur nuk është respektuar ky vendim, janë përcjellë tek përmbauesi. KPM vlerëson se kjo metodë ka qenë pozitive, pasi që ka rezultuar me grumbullimin e borxheve të vjetra dhe ka pasur një ndikim pozitiv në përmbushjen e obligimeve për pagesat në vitin pasues.

Gjatë zhvillimit të intervistave për qëllimin e draftimit të këtij raporti, u tha se KPM ka qenë aktive lidhur me këtë çështje⁷², dhe se vendimi i lartpërmendur u pa si shumë pozitiv⁷³, pasi që nuk do kishte qenë e mundur që mediat të shlyenin borxhet e tyre pa i'u dhënë mundësia për të planifikuar pagesa me këste.⁷⁴ Po ashtu, u theksua edhe një vendim tjetër i KPM, i cili parandalon kontestimin e faturave të KPM në gjykatë.⁷⁵

Ndërkaq, pati edhe mendime që nuk është bërë një progres i mjaftueshëm në këtë drejtim dhe se ka një stagnim.⁷⁶

3.9.1. Sfidat për mbledhjen e borxhit të RTK⁷⁷

Mbledhja e borxheve të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) nga ana e KPM-se mbetet një sfidë në vetë.⁷⁸ Siç u përmend më lartë, një pjesë e konsiderueshme e borxheve të grumbulluara ndaj KPM, janë borxhe nga tarifat e taksave, specifikisht 507,000 euro. Nga e cila shumë, 32% e borxhit të të licencuarve janë borxh i RTK.⁷⁹

⁷¹ “KPM refuzon kërkesën për ndryshim të pronësisë nga “Radio Shqip FM” tek “Klan Kosova””, Betimi për Drejtësi, 17 korrik 2023, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KPM-refuzon-kerkesen-per-ndryshim-te-pronesise-nga-radio-shqip-fm-tek-klan-kosova/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁷² Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

⁷³ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK; Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së; Intervistë me Besnik Berisha, Anëtar i KPM-së; Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së; Fitim Veliu - anëtar në KPM; Flaka Surroi – “Koha”.

⁷⁴ Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

⁷⁵ Ibid.

⁷⁶ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

⁷⁷ *Shënim: Të dhënat në këtë kapitull i takojnë periudhës gjatë së cilës është draftuar raporti*

⁷⁸ Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

⁷⁹ “Rreth 507 mijë euro borxh subjektet e licencuara KPM-së, 32% vetëm nga RTK”, Betimi për Drejtësi, 4 gusht 2023, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rreth-507-mije-euro-borxh-subjektet-e-licencuara-KPM-se-32-vetem-nga-rtk/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

RTK ka borxhe ndaj KPM që janë si rezultat i mos pagesës së taksës së licencës dhe dënimeve, që kapin vlerën prej 252,618.70. Po ashtu, vendimi i 17 korrikut të vitit 2023, që me të cilin kërkohej planifikimi i borxheve⁸⁰, gjithashtu vlente edhe për RTK.⁸¹

Sa i përket kësaj sfide, KPM mbajti disa mbledhje, duke përfshirë edhe diskutime në Komisione të Kuvendit, por ende nuk është gjetur një zgjedhje për këtë çështje.

Sipas KPM, RTK thotë se nuk ka buxhet për të paguar borxhin e grumbulluar ndër vite.

Lidhur me çështjen e borxheve ndaj KPM, shënimet e RTK tregojnë për një borxh prej vetëm 55,000 euro, përderisa regjistrat e KPM tregojnë se shuma e borxhit është 255,000 euro.⁸² Në një intervistë me një nga anëtarët e KPM-së, u tha se kjo diskrepancë në kalkulimin e borxheve është për shkak se RTK i llogaritë si borxhe vetëm rastet kur ka pasur një vendim gjyqësor. Gjithashtu, sipas të intervistuarit, gjatë një takimi mes anëtarëve të KPM-së dhe anëtarëve të bordit të RTK, është thënë se RTK do të regjistroj borxhin e mbetur në librat e tyre të llogarive, pasi të ketë vendim gjyqësor në favor të KPM-së lidhur me këto shuma.⁸³

3.10. Transparenca në pronësinë dhe koncentrimin medial

Pronësia dhe koncentrimi medial, si një nga çështjet kryesore e cila duhet të adresohet nga rregullatori i mediave, është theksuar në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2023⁸⁴. Në raport është thënë se mungesa e informacionit në lidhje me pronësinë mediale ishte një prej arsyeve pse KPM nuk ka shqiptuar masa efektive ndaj transmetuesve. Përderisa, është përmendur po ashtu se Ligji aktual për KPM ofron mjaftueshëm kompetenca rregullatore dhe monitoruese për të siguruar pluralizëm dhe konkurrencë në treg.⁸⁵

Sa i përket pronësisë dhe koncentrimin medial, KPM ka ndërmarrë disa veprime. Ligji aktual nuk e rregullon çështjen e pronësisë mediale. Kështu, miratimi i një rregullore në lidhje me çështjen e pronësisë dhe koncentrimin medial ishte shumë e nevojshme. Më 21 dhjetor 2023, hyri në fuqi Rregullorja për Pronësinë dhe Koncentrimin e të licencuarve të KPM⁸⁶, e cila sipas disa intervistave, ka qëndruar në sirtar me vite.⁸⁷

Kjo rregullore ka synuar që të vendos standard në lidhje me pluralizmin dhe diversitetin medial, si dhe transparencën në pronësinë mediale.⁸⁸

⁸⁰ KPM refuzon kërkesën për ndryshim të pronësisë nga "Radio Shqip FM" tek "Klan Kosova", Betimi për Drejtësi, 17 Korrik 2023, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KPM-refuzon-kerkesen-per-ndryshim-te-pronesise-nga-radio-shqip-fm-tek-klan-kosova/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁸¹ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së, 09.09.2024.

⁸² Fitim Veliu - anëtar në KPM.

⁸³ Ibid.

⁸⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovë, 2023. Faqe 96. (Shih linkun: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf).

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ "Miratohet Rregullorja për pronësinë dhe koncentrimin e mediave, parandalon monopolin dhe dominimin në treg", Betimi për Drejtësi, 21 dhjetor 2024; (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/miratohet-rregullorja-per-pronesine-dhe-koncentrimin-e-mediave-parandalon-monopolin-dhe-dominimin-ne-treg/>), (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

⁸⁷ Intervistë me Besnik Berisha, Anëtar i KPM-së.

⁸⁸ Regulation KPM-2023/03 on Media Ownership and Concentration, Article 1.

KPM po ashtu ndërmori hapa për të siguruar transparencë për pronësinë mediale⁸⁹ dhe për të parandaluar koncentrimin medial. Më 8 mars 2024, KPM lansoi hartën digjitale për pronësinë mediale⁹⁰, projekt i realizuar në bashkëpunim me OSBE-në. Gjatë lansimit, mes tjerash u bë e ditur se kjo platformë ofron të dhëna të detajuara mbi përqindjen e aksioneve në media, duke u theksuar se në të ardhmen do të plotësohet edhe me historikun e të dhënave, që i bie se do figurojnë edhe pronarët paraprak të medieeve.⁹¹ Kjo hartë përfshinë të gjitha subjektet e licencuara, dhe të dhënat e tyre verifikohen përmes raporteve vjetore të dorëzuara nga të licencuarit, pronësia e tyre e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), etj.⁹² Lansimi i kësaj harte u pa si një hap i madh në drejtim të rritjes së transparencës në pronësinë mediale.⁹³

Në anën tjetër, më 6 shtator 2024, KPM ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me ARBK-në. Sipas kësaj marrëveshje, ARBK para se të aprovojë ndryshimin e pronësisë, do kërkojë nga shoqëritë tregtare të licencuara nga KPM, të ofrojnë dëshmi që ndryshimi i pronësisë është aprovuar paraprakisht nga KPM⁹⁴.

Rritja e transparencës, në kuptimin e këtyre dy zhvillimeve u përmend edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë⁹⁵.

Për dallim nga ligji aktual, i cili nuk adreson çështjen e pronësisë mediale, ligji i ri e adreson, duke inkorporuar kryesisht përkufizimet e njëjta sikurse rregullorja e miratuar nga KPM.⁹⁶

Në të dyja rastet, është përcaktuar se çfarëdo ndryshimi të pronësisë mbi vlerën 10% të aksioneve të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja. Po ashtu ngjashëm është përcaktuar se asnjë i licencuar/regjistruar nuk mund të transmetojë më shumë se 30% të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale, dhe një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë me shumë se 10% të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër.

Përfshirja e përkufizimeve lidhur me çështjen e pronësisë mediale, fillimisht nuk ka qenë e planifikuar në draft ligj, mirëpo është inkorporuar gjatë amendementimit në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, Ligji i ri obligon KPM për të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar pronësinë dhe koncentrimin medial, pluralizmin dhe diversitetin, si dhe transparencën mediale⁹⁷.

⁸⁹ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

⁹⁰ “KPM lanson hartën digjitale të pronësisë së mediave”, Betimi për Drejtësi, 08 mars 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KPM-lanson-harten-digjitale-te-pronesise-se-mediave/>); Digital map, (shih linkun: <https://regjistri.KPM-ks.org/>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁹¹ “KPM lanson hartën digjitale të pronësisë së mediave”, Betimi për Drejtësi, 08 mars 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KPM-lanson-harten-digjitale-te-pronesise-se-mediave/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁹² Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së, 09.09.2024; Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

⁹³ Fitim Velu - anëtar në KPM; Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

⁹⁴ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3714.

⁹⁵ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

⁹⁶ Raport me rekomandime për Ligjin e ri për KPM, Neni 43, (shih linkun: https://drive.google.com/file/d/1Xe5rQs3565fGTnDqZc2e8bKIXIziZE5X/view?fbclid=IwY2xjawFNv8JleHRuA2FlbQIxM_AABHczxBwGgCftX_l6hqsXt6z9Lr_g62xZU4JzF8FI08h74exfzjtd8h-CISQ_aem_UvYaYWjw5FBbFQgrzHBRZQ). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

⁹⁷ Ibid, Article 42, Paragraph 2.

3.11. Shpërndarja e fondeve për reklama

Çështja e shpërndarjes së fondeve për reklama u theksua në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2023. Sipas këtij raporti, mungesa e informacionit lidhur me shpërndarjen e fondeve për reklama ishte një nga arsyet se pse KPM nuk ka arritur që të shqiptoj sanksione efektive ndaj transmetuesve.⁹⁸

Ndërsa, nga intervistat e realizuara del të jetë një çështje tjetër. Shpërndarja e fondeve për reklama nuk është ekskluzivisht nën juridiksionin e KPM-së, sepse industria e reklamave si tërësi ofron reklama të ndryshme për televizione dhe janë disa agjenci reklamash që ndërmjetësojnë mes biznesit dhe televizionit bazuar në rekomandimet që ato ofrojnë.⁹⁹

Kurse, KPM bazohet në raportet vjetore të dorëzuara nga mediet, ku mund të shihet vetëm totali i të ardhurave nga reklammat, por nuk është e ditur përtej kësaj, dhe nuk është në kompetencat e KPM-së për të ditur se kush janë reklamuesit.¹⁰⁰

Kështu, IKD vlerëson se kjo çështje duhet të adresohet nga KPM, dhe duhet të merren veprime lidhur me atë se si duhet t'i qasen këtij problemi.

3.12. Digjitalizimi

Procesi i digjitalizimit përfshinë tranzicionin nga transmetimi analog në transmetim digjital. Transmetimi digjital ofron disa avantazhe krahasuar me transmetimin analog, përfshirë kualitet më i lartë i pamjes dhe zërit, numër më i madh i programeve televizive në dispozicion për shikuesit pa ndonjë kosto shtesë, mundësi për të zgjedhur programet on demand, interaktivitet, siguron qasje për personat me pengesa në shikim dhe të dëgjuar për të ndjekur programet televizive, etj.¹⁰¹

KPM ka iniciuar procesin e digjitalizimit duke dorëzuar një Strategji për Kalim në Transmetim Digjital Tokësor në Republikën e Kosovës, tek Qeveria e Kosovës në dhjetor 2019.¹⁰² Sidoqoftë, sipas një përgjigje nga Zyra për Planifikim Strategjik – Zyra e Kryeministrit, kjo strategji nuk është miratuar nga Qeveria për shkak të disa çështjeve me të cilat është përballur, një prej kryesoreve duke qenë kostoja e lartë e implementimit të kësaj strategjie, një kosto për të cilën nuk është llogaritur në buxhet. Ndërsa, në këtë përgjigje, thuhet se pavarësisht sugjerimeve të kësaj Zyre në atë kohë për të reduktuar kostot dhe riaranzhuar aktivitetet, kjo nuk ndodhi, dhe si rezultat, strategjia ka mbetur pa u miratuar.¹⁰³

Gjithashtu, thuhet se nga KPM është bërë një tentativë tjetër për të miratuar këtë strategji në shtator 2021. Në atë kohë, gjatë një takimi të mbajtur me KPM, Zyra për Planifikim Strategjik

⁹⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovë, 2023. Faqe 96. (Shih linkun: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf).

⁹⁹ Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

¹⁰⁰ Ibid.

¹⁰¹ IMC's web-site, "Digitalization", (shih linkun: <https://www.IMC-ks.org/aktivitete/301/digjitalizimi/301#systemsetting1>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹⁰² Strategjia për Kalimin në Transmetim Digjital Tokësor në Kosovë, 16 December 2019, (shih linkun: https://www.IMC-ks.org/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20p%C3%ABr%20kalim%20n%C3%AB%20transmetim%20digjital%20tok%C3%ABsor_%20dhjetor%202019.pdf), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹⁰³ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit, 31 janar 2024.

rekomandoi disa hapa për t'u rishikuar draft strategjia, ashtu që të mundësohet miratimi i saj, ku janë propozuar tri hapa.

Ndërkaq, thuhet se pas këtij komunikimi nga Zyra e Kryeministrit, më nuk ka pasur ndonjë iniciativë nga ana e KPM-së për të adresuar këto pika dhe për të miratuar strategjinë.¹⁰⁴ KPM po ashtu e konfirmon se nuk janë bërë zhvillime në këtë drejtim, sipas tyre, ky proces ka stagnuar për shkak të mungesës së buxhetit.¹⁰⁵

3.13. Resurset e KPM-së

Çështja e resurseve njerëzore dhe teknologjike varet nga politikat e institucionit, konkretisht nga objektivat të cilat i vendos për t'i arritur. Megjithatë, me objektivat dhe përgjegjësitë aktuale, ku numri i të licencuarve është gjashtëfishuar që nga themelimi i institucionit, ndërsa numri i stafit ka mbetur pothuajse i njëjti, ka nevojë t'i rrisë kapacitetet njerëzore dhe veçanërisht teknologjike, për shkak të zhvillimeve të shpejta, sidomos në inteligjencën artificiale.

Gjithashtu, me ligjin e ri, detyrat e KPM-së zgjerohen, ku përfshihet edhe rregullimi i mediave online, si dhe duke marrë parasysh edhe rritjen e vazhdueshme të numrit të ankesave që pranohen nga KPM. Kështu, nevoja për rritjen e kapaciteteve të KPM-së nuk është e kontestueshme nga asnjë prej të intervistuarve.¹⁰⁶

Nga zhvillimi i intervistës me përfaqësuesin e Zyrës së BE në Kosovë, u tha se Kuvendi i Kosovës duhet që KPM-së t'i sigurojë buxhet dhe resurse, pasi edhe po i shtojnë detyrat.¹⁰⁷ Sipas kësaj interviste, është pikëpyetje nëse Kuvendi i Kosovës ka paraparë resurset e nevojshme për KPM, përderisa ata i shtojnë detyra atyre.¹⁰⁸

KPM ka kërkuar rritje të buxhetit për t'i rritur këto kapacitete. Konkretisht, ka kërkuar 27 zyrtarë, por që kjo kërkesë nuk është miratuar, me arsyetimin e shkurtesave të buxhetit. Kërkesa është aprovuar vetëm për pesë zyrtarë, të cilët do të shpërndahen nëpër departamente të ndryshme, varësisht nga ngarkesa e punës. Lidhur me funksionimin e KPM-së, veçanërisht me synimin për t'u shtuar kompetencat e këtij institucioni sipas ligjit të ri, është esenciale për të realizuar një analizë adekuate të nevojave të KPM-së për të ushtruar mandatein e saj. Përndryshe, miratimi i ligjeve pa pasur një mbështetje buxhetore adekuate, rrezikon që të mos ketë implementim të plotë të legjislacionit të aprovuar dhe si rezultat, dështimin për t'i arritur qëllimet e synuara.

Në anën tjetër, KPM-së nuk është duke i munguar mbështetja nga donatorë të jashtëm, dhe kjo mbështetje ofrohet për fusha të ndryshme. Kryesisht në fusha ku nevoja për përkrahje është më urgjente dhe për çka nuk ka pasur buxhet më herët, sikurse në draftimin e legjislacionit të ri, përkrahja e fuqizimit të medias dhe publikut në mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në media, dhe rritja e transparencës sa i përket qasjes në regjistrat e pronarëve të medieve.¹⁰⁹

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së.

¹⁰⁶ Intervistë me Christian Bötcher; Faruk Rexhaj; Besnik Berisha; Valon Ramadani; Imer Mushkolaj; Isak Shabani; Jeton Mehmeti; Flaka Surroi; Fitim Veliu; Imer Mushkolaj.

¹⁰⁷ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë

¹⁰⁸ Ibid.

¹⁰⁹ Përgjigje me shkrim nga Zyra për Komunikim me Publik e KPM-së.

3.14. Sulmi ndaj pavarësisë së KPM-së

Kapitulli 7 i Kushtetutës garanton pavarësinë dhe funksionalitetin e institucioneve të pavarura. Brenda këtij kapitulli është e përfshirë edhe KPM. Sipas Kushtetutës [Neni 141] “1. Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. 2. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhën sipas ligjit, përmes një procesi transparent”. Megjithatë, pavarësia e KPM-së ka qenë e kompromituar në disa raste dhe në disa mënyra, sikurse sulmet nga Kuvendi, lidhur me vendimet e marra nga KPM, të cilat bien brenda mandatit të këtij institucioni kushtetues të pavarur. Gjithashtu, kjo pavarësi është kompromentuar edhe me Ligjin e ri për KPM, kushtetutshmëria e të cilit aktualisht është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese.

3.14.1. Presioni nga deputetët e Kuvendit të Kosovës

Në mbledhjen e mbajtur më 6 shkurt 2024, KPM morri vendim përmes të cilit lejoi rikthimin në transmetim të kanaleve të Arena Sport.¹¹⁰ Megjithatë, për këtë vendim, KPM është ftuar disa herë për të raportuar në Kuvendin e Kosovës, ku Kryetari dhe anëtarët e KPM-së janë përballur me sulme të papranueshme, përfshirë edhe akuza për tradhti publike.¹¹¹ Guximi i KPM-së për të marrë vendime pavarësisht presioneve është përmendur edhe gjatë intervistave¹¹². Thirrja e rregullatorit për të raportuar mbi vendime specifike nuk ishte e pazakontë, veçanërisht kur debati ka kaluar nga çështje profesionale në çështje politike, gjë e cila ndikon në pavarësinë e KPM-së.¹¹³ Megjithatë, qasja e kontrollit "policor", në vend të një mbikëqyrjeje parlamentare ndaj një institucioni të pavarur, është absolutisht e papranueshme.¹¹⁴ Këto takime janë monitoruar nga afër edhe nga Ambasada Gjermane në Kosovë. Sipas tyre, veprimet e Kuvendit ishin “shumë të ashpra”, sikurse synohej diskreditimi i dikujt.¹¹⁵ Po ashtu, të intervistuar brenda KPM-së i përshkruan ato veprime si të tepruara¹¹⁶, duke theksuar se qasja e tyre ishte agresive, fyese dhe shpifëse.¹¹⁷ Përgjigje të njëjta u dhanë nga akterë tjerë, të cilët e quajtën këtë qasje si brutale dhe ndërhyrje drektë në punën e anëtarëve, si presion për të tentuar të ndikojnë në vendimmarrje të anëtarëve.¹¹⁸

Ndërkaq, gjatë një interviste me një deputet i partisë opozitare (PDK), ai tha se pavarësia e KPM ka qenë e kompromentuar, dhe se së fundmi nuk ka qenë e mundur që si anëtarë të zgjidhet dikush që nuk ka pasur mbështetje nga partia në pushtet.¹¹⁹ Ndërsa, e kundërta u tha nga anëtari i Komisionit Parlamentar nga radhët e partisë në pushtet, duke deklaruar se diskutimet kanë qenë publike dhe se nuk ka pasur nga dikush ndonjë ndikim ose tentim për të ndikuar në KPM, por që dikush ka mundur që të ketë diskurs më të ashpër për shkak të

¹¹⁰ Announcement from the second meeting of the Independent Media Commission, 07 February 2024, (shih linkun: https://www.IMC-ks.org/lajmi_i_plot/3664), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹¹¹ “Politizimi i KPM (Analizë e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media”, Kosovo Law Institute, Korrik 2024, Prishtina, Page 7, (shih linkun: [file:///C:/Users/KLI20/Downloads/Raporti-Politizimi-i-IMC-se-Analize-e-Ligjit-per-Komisionin-e-Pavarur-te-Medive-1%20\(6\).pdf](file:///C:/Users/KLI20/Downloads/Raporti-Politizimi-i-IMC-se-Analize-e-Ligjit-per-Komisionin-e-Pavarur-te-Medive-1%20(6).pdf)), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹¹² Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkingags, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Cështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

¹¹³ Intervistë me Ardita Zejnnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK.

¹¹⁴ Intervistë me Flaka Surroi – “Koha”.

¹¹⁵ Intervistë me Christian Bötcher – kreu për Kulturë, Shtyp dhe Komunikime në Ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë.

¹¹⁶ Intervistë me Faruk Rexhaj - U.D Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së.

¹¹⁷ Intervistë me Jeton Mehmeti - Kryetar i KPM-së.

¹¹⁸ Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i KMSHk.

¹¹⁹ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

ndjeshmërisë së çështjeve të cilat kanë qenë duke u diskutuar.¹²⁰ Se Kuvendi ka pasur të drejtë në reagimet e tyre u tha edhe nga një anëtarë i KPM-së, sipas të cilit, rikthimi i kanaleve të Arena Sport doli të jetë një çështje problematike shtesë, dhe se ata janë deputetë dhe kanë të drejtën të shprehin mendimet e tyre, duke shtuar se ato reagime nuk kanë qenë ndikuese, për shkak se anëtarët e KPM-së dhe deputetët kanë përgjegjësi të ndryshme.¹²¹

3.14.2. Ligji i ri për KPM

Ligji i ri për KPM, i cili është pjesërisht në përputhje me EUVAMSD, nxiti reagime nga partnerët ndërkombëtarë, media, dhe organizata të shoqërisë civile, duke theksuar se shumica e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë, në emër të Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe OSBE, nuk u morën parasysh¹²², dhe se pavarësia e KPM-së është e kompromentuar.¹²³ Në përgjithësi u konsiderua se ishte një draft shumë i mirë deri në nëntor 2023 kur doli një draft i ri i cili ngriti shqetësime.¹²⁴ U tha se Zyra e BE-së arriti që të bind Këshillin e Evropës për të ofruar një ekspertizë për këtë çështje, por që në disa raste ishte vepruar ndryshe nga ajo që kishte rekomanduar eksperti¹²⁵. Po ashtu, Zyra e BE-së në Kosovë theksoi se do donin që procedura e konsultimeve publike të respektohej në mënyrë strikte, ku komentet duhet të lexohen një nga një dhe të arsyetohej se përse “kjo nuk pranohet/akceptohet”, duke shtuar që komisionet e Kuvendit duhet që t’i marrin seriozisht përgjegjësitë e tyre¹²⁶.

Gjatë intervistave, u tha se me Ligjin e ri për KPM ka një rrezik që të cenohen të drejtat e mediave pikërisht në kohën e zgjedhjeve të përgjithshme, ashtu që nuk do ketë kritika në drejtim të qeverisë¹²⁷.

Gjithashtu, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e panë këtë ligj si një sulm ndaj lirisë së mediave dhe një tentim për të kontrolluar mediat¹²⁸ Ky Ligj po ashtu u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga dy partitë opozitare (PDK dhe LDK)¹²⁹, si dhe u dërguan komente nga AGK.¹³⁰

¹²⁰ Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media.

¹²¹ Fitim Veliu - anëtar në KPM.

¹²² “OSCE: Most of the recommendations of international experts have not been taken into account in the Law on IMC”, Oath of Justice, korrik 11, 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/osbe-shumica-e-rekomandimeve-te-eksperteve-nderkombetare-nuk-jane-marre-parasysh-ne-ligjin-per-kpm-ne/>); OSCE Mission in Kosovo statement on the new Law on the Independent Media Commission. OSCE. Korrik 11, 2024. (Shih linkun: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/572641>). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹²³ “The draft law on IMC should not enter into force”, Human Rights Network, Korrik 13, 2024. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/share/R8bYscb3hsf63ZEC/>); (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹²⁴ Intervistë me Jarmo Feliks Helipinkings, Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë.

¹²⁵ Ibid.

¹²⁶ Ibid.

¹²⁷ Intervistë me Christian Bötcher – kreu për Kulturë, Shtyp dhe Komunikime në Ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë.

¹²⁸ “AJK: Adoption of the Law on IMC, attack on freedom of the media and attempt to discipline and control them”, korrik 11, 2024. (Shih linkun: [AGK: Miratimi i Ligjit për IMC-në, goditje ndaj lirisë së medies dhe tentim për disiplinim e kontroll të tyre | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK \(agk-ks.org\)](https://www.facebook.com/share/R8bYscb3hsf63ZEC/)). (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹²⁹ “PDK-ja i dërgon në Kushtetuese Ligjin për KPK-në, KPM-në dhe Statutin e UP-së”, Betimi për Drejtësi, 18 korrik 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pdk-ja-i-dergon-ne-kushtetuese-ligjin-per-kpk-ne-IMC-ne-dhe-statutin-e-up-se/>); “Edhe LDK-ja kërkon vlerësim nga Kushtetuesja për Ligjin e KPM-së, KPK-së dhe Statutit të UP-së”, Betimi për Drejtësi, 19 korrik 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/edhe-ldk-ja-kerkon-vleresim-nga-kushtetuesja-per-ligjin-e-IMC-se-kpk-se-dhe-statutin-te-up-se/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹³⁰ “AGK dorëzon në Kushtetuese komentet lidhur me Ligjin për KPM-në”, Betimi për Drejtësi, 20 gusht 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/agk-dorezon-ne-kushtetuese-komentet-lidhur-me-ligjin-per-IMC-ne/>).

Ndërsa, IKD e ka analizuar Ligjin e ri dhe ka publikuar një raport të detajuar lidhur me politizimin e KPM-së nga partia politike në pushtet¹³¹, i cili raport u publikua përmes një konference për medie.¹³²

Në këtë raport, mes tjerash, IKD thekson se nevoja për të miratuar Ligjin e ri për KPM-në nuk e nënkupton mundësinë që Kuvendi të cenoj pavarësinë kushtetuese të KPM-së. Ligji i ri duhet të përshtatet me nevojat dhe zhvillimet e reja. Nëse kjo nuk ndodh, ligji i ri mund të rrezikojë që ai vet të cenoj punën e këtij institucioni të pavarur kushtetues. Gjithashtu, duke e rritur numrin e anëtarëve në 11, ekziston rreziku që të defaktorizoj pesë anëtarët aktual, për shkak se vendimet do mund të merreshin vetëm me votat e gjashtë anëtarëve të rinj. Megjithatë, për këtë nuk u dha ndonjë arsye, dhe se në çfarë situatash, rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së mundet t'i ngjajë një tentimi për një politizim të plotë dhe të shpejtë të KPM-së.¹³³

Në raportin e lartpërmendur, IKD ka gjetur një çështje problematike lidhur me zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KPM, pasi që Ligji i ri e lejon Kuvendin jo vetëm që të zgjedh por edhe të shkarkojë anëtarë të KPM-së në rastet kur Kuvendi humb besimin në ta. Lidhur me shkarkimin e anëtarëve, në draftin e ri të këtij Ligji, Komisioni Parlamentar nuk mundet që të shkarkojë të gjithë anëtarët përnjëherë.

Megjithatë, këto kritere i mundësojnë mazhorancës në Kuvend që të ndryshojnë përbërjen e KPM-së në çdo kohë. Kjo situatë vendos presion mbi të gjithë anëtarët e KPM. Për më tepër, roli i Kuvendit në KPM shtrihet deri në pikën e zgjedhjes së kryetarit, për dallim nga institucione tjera kolegjiale. Kështu, përderisa një Qeveri e ka shumicën parlamentare, nënkupton se ajo Qeveri mund të politizoj KPM-në në çdo kohë. Kjo, duke i emëruar dhe shkarkuar anëtarët dhe kryetarin e tyre.¹³⁴

Ligji i ri për KPM-në u pa si shqetësues edhe nga Ambasada Gjermane në Kosovë, e cila ka marrë pjesë në komentet e BE-së. Ata shprehen pakënaqësi dhe theksuar se e kanë të vështirë të kuptojnë pse ka ndodhur një gjë e tillë, duke shtuar se nëse qëllimi është avancimi i Kosovës drejt Bashkimit Evropian, komentet dhe rekomandimet e BE-së duhet të merren parasysh.¹³⁵

Përderisa, akterë të tjerë po ashtu e përshkruan Ligjin e ri për KPM-në si problematik, duke theksuar shqetësimet rreth numrit të anëtarëve dhe kohëzgjatjes së mandatit të tyre.¹³⁶ Gjithashtu, u tha edhe se ky ligj e cenon rëndë pavarësinë e KPM.¹³⁷

Ndërkaq, rregullimi i mediave online me Ligjin e ri u pa si i paqartë.¹³⁸ Kurse, mendim krejt tjetër u dha nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Media, që vije nga radhët e partisë në pushtet, i cili nuk e sheh Ligjin e ri të cenojë pavarësinë e KPM-së. Sipas tij, nuk ka bazë të

¹³¹ “Politizimi i KPM (Analizë e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media”, Kosovo Law Institute, korrik 2024, Prishtina, (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-Politizimi-i-KPM-se-Analize-e-Ligjit-per-Komisionin-e-Pavarur-te-Mediave-1.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹³²“IKD: Ligji për KPM shkatërron tërësisht pavarësinë kushtetuese të këtij institucioni” Betimi për Drejtësi, 19 korrik 2024, (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/KLI-ligji-per-IMC-shkaterron-teresisht-pavaresine-kushtetuese-te-ketij-institucioni/>), (Qasur për herë të fundit më 13 shtator 2024).

¹³³ Ibid, Page 13-15

¹³⁴ Ibid, Page 19.

¹³⁵ Intervistë me Christian Bötcher – kreu për Kulturë, Shtyp dhe Komunikime në Ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë.

¹³⁶ Intervistë me Imer Mushkolaj – Drejtor Ekzekutiv i KMSHK; Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK.

¹³⁷ Intervistë me Isak Shabani – Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media.

¹³⁸ Intervistë me Ardita Zejnullahu – Drejtoreshë Ekzekutive AMPEK.

thuhet se pavarësia e këtij institucioni cenohet nga ndonjë dispozitë, përkundrazi, ai deklaroi se Ligji i ri vetëm se e forcon pavarësinë e KPM.¹³⁹

4. Konkluzionet

KPM ka bërë përpjekje për të zvogëluar numrin e punëve të cilat ishte grumbulluar si rezultat i mosfunksionimit të vet për rreth shtatë muaj (tetor 2022 – maj 2023).

Ndërsa, BA ka vazhduar të mbetet jofunksional nga 29 tetori i 2023, për shkak se ka pasur vetëm një anëtar, i cili ishte zgjedhur në qershor të atij viti. Ligji i ri për KPM-në nuk e parasheh si organ të KPM-së BA-në, duke lënë palët e pakënaqura që t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Sa i përket transparencës, KPM njofton për caktimin e mbledhjeve dhe publikon komunikata pas mbledhjeve, në faqen e tyre zyrtare, duke informuar publikun për zhvillimet kryesore. Megjithatë, vendimet për këto mbledhje (maj – gusht) nuk janë publikuar.

Po ashtu, KPM ka lansuar një hartë digjitale duke i ofruar publikut qasje në të dhënat e të licencuarve, lidhur me pronësinë e tyre. Kjo hartë ka qenë një hap pozitiv mjaftë i rëndësishëm në drejtim të transparencës të pronësisë mediale.

Resurset njerëzore dhe teknike të KPM-së janë të pamjaftueshme për të ushtruar detyrat e saj, veçanërisht duke pasur parasysh që numri i të licencuarve deri tani është rritur për gjashtëfish, ndërsa numri i stafit mbetet njëjtë, i pandryshuar. Rritja e numrit të stafit bëhet ende më i nevojshëm në kohën kur po synohet zgjerimi i kompetencave të këtij institucioni.

Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton disa obligime shtesë për KPM-në. Në mënyrë që të zbatohen këto obligime, KPM është dashur të miratojë rregullore përkatëse. Për këtë, IKD ka ofruar mbështetje pro bono, në draftimin e rregullores lidhur me zbatimin e këtyre obligimeve që derivojnë nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Lidhur me këtë, KPM në dhjetor të vitit 2024, ka aprovuar Rregulloren për obligimet e ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatës zgjedhore.

KPM kryen monitorim më adekuat dhe specifik duke u bazuar në ankesat të cilat i pranon. Ky institucion tani është duke finalizuar përgatitjet për të monitoruar të licencuarit gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të shkurtit 2025. Në kuptimin e sanksioneve, KPM ka shqiptuar gjopa në vlerën totale prej 149,000.00 euro, përgjatë tetë muajve të fundit, kurse gjopa më e lartë e shqiptuar është 64,000.00 euro. Nga 1 maj deri 15 gusht 2024, KPM ka iniciuar 79 raste ndaj transmetuesve, ndërsa janë shqiptuar gjopa që kapin shumë totale prej 10,000.00 euro.

Në të ardhmen, KPM nuk duhet t'i trajtojë rastet ku ankesat janë konsoliduar si një vendim të vetëm disiplinor, por në vend të kësaj duhet t'i trajtojë gjopat si vendime individuale për secilin licencues. Sanksionet janë individuale dhe nuk janë të lidhura me sanksione tjera, thjeshtë pse ankesat janë të natyrës së njëjtë dhe janë pranuar brenda një periudhe kohore relativisht të njëjtë. Konsolidimi i procedurës paraqet një veprim procedural dhe jo një lidhje mes sanksioneve. Për këtë arsye, KPM duhet të shqiptojë sanksione individuale për secilin subjekt të ankesës që është gjetur se ka bërë shkelje, dhe jo një gjobë të vetme për disa subjekte. Kështu, maksimumi i dënimit prej 100,000.00 euro, duhet që të konsiderohet për secilën shkelje dhe jo si maksimum për të gjitha shkeljet si tërësi. Mënyra se si kjo dispozitë është interpretuar nga

¹³⁹ Intervistë me Valon Ramadan – Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media.

KPM përbënë një aplikim jo adekuat të Ligjit, implementim të kundërligjshëm të politikës ndëshkimore, dhe potencialisht dëmtim të buxhetit.

Sa i përket borxheve të mbetura, një vendim i KPM-së, i korrikut të vitit 2023, rezultoi me një pagim të borxheve në shumën prej 123,774.21 euro. Megjithatë, sfida kryesore mbetet tek borxhi i akumuluar i RTK-së, i cili përbën pjesën më të madhe të borxheve.

Që nga ri-funksionalizimi i KPM-së, në pjesën e dytë të vitit 2023, deri në dhjetor të vitit 2024, ky institucion ka miratuar shtatë rregullore: 1) Rregulloren për Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinimin e Kryeshefit Ekzekutiv; 2) Rregulloren për Pronësinë dhe Koncentrimin e të Licencuarve të KPM-së; 3) Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale; 4) Rregulloren për Komunikimet Komerciale në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale; 5) Rregulloren për Mbrojtjen e Përdoruesve në fushën e Ofrimit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale; 6) Rregulloren për Procedurën e Trajtimin të Ankesave në KPM; dhe 7) Rregulloren për obligimet e ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatës zgjedhore.

KPM ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me ARBK, përmes të cilës parashihet që ARBK të mos lejoj ndryshim të pronësisë për të licencuarit e KPM-së, pa një miratim paraprak nga ana e saj.

Ndërkaq, lidhur me procesin e digjitalizimit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim.

Anëtarët e KPM-sw janë përballur me sulme të ndryshme nga deputetë të partisë në pushtet. KPM është ftuar tri herë që të raportojë para Komisionit Parlamentar për Media lidhur me vendimmarrjen e saj. Këto sulme përfshinë forma të ndryshme të denigrimit, përfshirë edhe akuza për tradhti kombëtare.

Përveç këtyre sulmeve, pavarësia e KPM-së u cenua edhe nga Ligji i ri, kushtetutshmëria e të cilit është duke u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese.

5. Rekomandimet

5.1. Rekomandimet për KPM

1. KPM duhet që të publikojë të gjitha vendimet e tyre në faqen zyrtare, në gjuhët zyrtare;
2. KPM duhet të sigurohet që harta digjitale të jetë vazhdimisht funksionale;
3. KPM nuk duhet që të trajtojë ankesat e natyrës së njëjtë si një sanksion i vetëm (duke e ndarë shumën e gjobës si proporcionalisht) për disa subjekte të licencuara, por si një sanksion të veçantë ndaj secilit të licencuar, pavarësisht subjekteve tjera të licencuara;
4. Ndonëse ka pasur progres në mbledhjen e borxheve të grumbulluara ndaj KPM ndër vite, duhet që të vazhdohet me përpjekjet për të mbledhur edhe borxhin e mbetur.

5.2. Rekomandimet për Kuvendin

1. Për të kompletuar përbërjen dhe për të forcuar legjitimitetin e vendimeve të KPM-së, Kuvendi duhet që të zgjedh edhe anëtarët e tjerë të KPM;
2. Kuvendi duhet që të adresoj kërkesat buxhetore të KPM-së. Zgjerimi i kompetencave të KPM-së duhet që të përcjellët edhe me resurse të nevojshme buxhetore për të mundësuar zbatimin e obligimeve të tyre ligjore;
3. Kuvendi duhet të punojë në drejtim të funksionalizimit të Bordit të Ankesave, pasi Ligji aktual është ende në fuqi dhe ligji i ri është në pritje të një vendimi nga Gjykata Kushtetuese;
4. Kuvendi duhet të ndaloj ushtrimin e presionit dhe sulmet mbi anëtarët e KPM-së, për tu siguruar se nuk ka përpjekje për të ndikuar tek ta;
5. Kuvendi i Kosovës duhet ta ruajë pavarësinë kushtetuese të KPM-së, si përmes ligjeve që miraton, ashtu edhe përmes veprimeve që ndërmerr.

5.3. Rekomandime të përgjithshme

1. Duhet që të planifikohet dhe të merren veprime për të implementuar procesin e digjitalizimit;
2. Duhet që të bëhen përpjekje për të arritur marrëveshje mes KPM-së dhe RTK-së për të shlyer borxhet nga kjo e fundit, duke pasur parasysh që buxheti i këtyre institucioneve derivon nga buxheti i Kosovës.

6. Annexes

6.2. Annex 1. Mbledhja e të dhënave dhe dokumentet kryesore të konsultuara

- Mbledhjet e rregullta të KPM;
- Web-faqja zyrtare e KPM dhe faqja zyrtare në Facebook;
- Përgjigje me shkrim nga KPM në kërkesat për informata;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023;
- Raporti i IKD “Politizimi i KPM”;
- Ligji i ri për KPM;
- Ligji për KPM;
- Rregulloret e KPM;
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.

6.2. Annex 2. Lista e të intervistuarve:

Emri	Pozita
Jeton Mehmeti	Kryetar i KPM ¹⁴⁰
Besnik Berisha	Anëtar i KPM
Faruk Rexhaj	U.D. Kryeshef Ekzekutiv i KPM
Valon Ramadani	Deputet – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Media
Isak Shabani	Deputet – Anëtar i Komisionit Parlamentar për Media
Ardita Zejnullahu	Drejtoreshë Ekzekutive në AMPEK
Flaka Surroi	Director of the publishing and media company “Koha Group”
Imer Mushkolaj	Drejtor Ekzekutiv i KMSHK
Christian Bötcher	Kreu për Kulturë, Shtyp dhe Komunikime në Ambasadën Gjermane në Prishtinë
Jarmo Feliks Helppikangas	Shef i Njësisë për Sundimin e Ligjit, Cështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Zyra e BE në Kosovë
Fitim Veliu	Anëtar i KPM

¹⁴⁰ *Shënim:* Në kohën e publikimit të këtij raporti, mandati i kryetarit të KPM, Jeton Mehmeti, ka skaduar.